

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .09.2021

**ALBPETROL SHA PATOS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 24.09.2021

Nga: "Albpetrol "sha - Patos

Drejtuar: "ARDIT - 06" shpk,

Adresa: Zharrëz, Rruga Nacionale Fier-Berat, Banesa 230, Fier

NIUS K63027403V

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04044-08-27-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Ndertim RVM 1500 m³ ne parkun e vjeter Dekantimin Gorisht (trajtim naftë ne te ftohte me servo)"

Kohezgjatja e kontrates është 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.132 date 07 Shtator 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "SHKELQIMI 07" shpk me NIUS K68121808W, me vlerë oferte në total 12,500,000 lekë (pa TVSH).
2. Operatori ekonomik "ARDIT - 06" shpk me NIUS K63027403V, me vlerë oferte në total 13,976,934 lekë (pa TVSH).

Nga pjesemarresit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik "SHKELQIMI 07" shpk me NIUS K68121808W për arsyet e mëposhteme:

- Nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit stafin teknik për punonjësit specialistë të kualifikuar në kundërshtim me pikën 2.3.3. germa d. gjithësesi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për personelin inxhiniero-teknik të kërkuar rezultoi se:
- Nuk ka paraqitur diplomën e arsimit të lartë për inxhinierin mekanik në kundërshtim me kërkesën e shkronjës a të pikës 2.3.3 të DST-së,
- Ka paraqitur certifikate si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" të paktën për njërin nga inxhinierët drejtues teknikë, por kjo certifikate rezultoi të jetë me afat të skaduar, në kundërshtim me kërkesën e shkronjës b të pikës 2.3.3 të DST-së.

- Punonjësit specialistë hidraulikë K. Y. dhe P. A., nuk rezultojne te jenë në listëpagesat e shoqërisë për muajin gusht, në kundërshtim me kërkesën e shkronjës c të pikës 2.3.3 të DST-së.
- Ka paraqitur dokumentacion vetem per 2 saldatore nga 3 te kerkuar, ndersa per specialistin saldator D. R. nuk ka paraqitur dëshmi kualifikimi profesionale, diplomë ose certifikatë, lëshuar nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, në kundërshtim me kërkesën e shkronjës c të pikës 2.3.3 të DST-së.
- Për punonjësit specialistë karpentierë: nga 2 të kërkuar vetem njeri prej tyre, F. I. ka certifikatë kualifikimi, në kundërshtim me kërkesën e shkronjës c të pikës 2.3.3 të DST-së.
- Nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit mjetet Kalandër dhe Zmucatrice ne kundërshtim me piken 2.3.3. germa d, te DST-se, gjithsesi nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur per mjetet gjithashtu rezulton se nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion per mjetet e siperpermendura

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ARDIT - 06” shpk, me NIUS K63027403V me adrese Zharrëz, Rruga Nacionale Fier-Berat, Banesa 230, Fier, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13,976,934 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) leke pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Florjan MUÇAJ